



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" REKTORI

Departamenti i *Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar* në Fakultetin e Shkencave të Edukimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksander Xhuvani" për nevojat e tij për zhvillimin e procesit mësimor, për vitin akademik 2022-2023, shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme

Kriteret e përgjithshme e të veçanta të konkurrimit për pozicionin e punës personel akademik me kohë të pjesshme

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare (Ba dhe Master i Shkencave apo ekuivalente me të) brenda ose jashtë vendit në fushën e *Punës Sociale* me notë mesatare mbi 8.5. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Preferohet të ketë mbajë gradën *Doktor* i Shkencave, *Doktor në proces* ose *tituj të tjerë akademikë* të fituara brenda ose jashtë vendit; (Titulli/Grada e fituar në Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
3. Preferohet të jetë i punësuar në sektorin publik ose privat në fushën e sektorit të shërbimeve sociale.
4. Të ketë përvojë në fushën e mësimdhënies akademike.
5. Të ketë aftësi prezantuese.
6. Të jetë bashkëpunues/e dhe të ketë të paktën dy referenca nga profesorë të fakultetit ose punësdhënësit të tij/saj.
7. Në rastet e pedagogëve të angazhuar gjatë viteve pranë departamentit të ketë dhe vlerësimin për punën e kryer nga titullari i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit.
8. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së, e mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi.
9. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.
10. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **14.09.2022-23.09.2022** këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

4. Dokumentacionin shoqërues përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës me gojë* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në **rrugë postare 14.09.2022** deri **23.09.2022**

Adresa postare:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim në Fakultetin e Shkencave të Edukimit
Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar
Elbasan**